

NGA MJALTI I MENÇURISË NJERËZORE

*Po gave nga gjëzimi,
mos i fshi lotët sepse ti
ia vjedh ato dhembjes.*

*Toulet***KËNDI I VJERSHËRIMIT**Nga Sergej ESENIN**SHAGANE**

*Putmë mua, putmë fort,
Të më dhembë, me tërbim.
Gjaku im më përvëlo,
Kurse shpirti akull ngrin.*

*Kup' e derdhur, e përbysur
Mes gjëzimit nuk na shkon.
E kupto moj mike e ngrysur:
Veç një jet' njeri rron.*

*Shiko rrrotull qetë-qetë
Mugëtirën quill të lagur,
Hëna si një korb i verdhë
Sillet rrrotull prej së largu.*

*Putmë, po të them, më puth!
Fundi psallmin tim më tha,
Hën e verdhë si kukudh
Vdekjen time po nuhat.*

*Afshi im fle i venitur!
Vdekja erdh', mirësevjen!
Buz' më buz të puthitur
Fundi im, mbasë, më gjen.*

*Nëpër èndrra që nuk prishen,
Pa lektisje e pa drojtje,
Nën kurorën e një vishnjë
Të më thuash: "Jam e jotja"*

*Që me shkumbën e një kupe
Mos na ikë drit' e shtrenjtë,
Më këndo, o mike, putmë,
S'kemi tjetër, veç një jetë.*

LAMTUMIRË

*Lamtumirë, mik, qenka e thënë.
Mik i dashur brenda zemrës je.
Ndarja jonë, ndarj' e parathënë
Na prentan takimin që po vjen.*

*Lamtumirë, miku yt thotë,
Vetullat mos ngrys, mos u mërzit,
S'është gjë e re vdekja në botë,
Po dhe jeta vetë s'të çudit.*



Sergei Esenin

"KU KA ZË NUK ËSHTË PA GJË" QËNDRON EDHE PËR POETIN ADNAN MEHMETI

NGA GJEKË MARINA

Poeti Adnan Mehmeti, anëtar i Shoqatës së Shkrimitarëve Shqiptaro-Amerikanë, ka filluar të bëhet subjekt bisëde edhe për lexuesit amerikan të poezisë. Këtë herë përgjegjësinë e "përgjimeve" e mbanë libri i tij më i ri "Leave the door open." Ai po gjëne dyer të hapura jo vetëm në shtëpitë private, por edhe në ato publike të dashamirësve të letërsisë.

Lufkin Daily News, ua ka sugjeruar blerësve dhe abonentëve të saj emrin e Mehmetit si "Autor i vlerëshëm për t'u lexuar" që në ditët e para të daljes së librit nga shtypi.

Një ftesë për të marrë pjesë në Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë, të cilin e sponsorizon për më se njëzet vjet Universiteti i Houston-it, vërtetojë se mesazhi i gazetës së qytetit ku jeton poeti nuk kishte rënë në veshë të shurdhët.

"Libri 'Leave the door open' na bindi se Adnam Mehmeti do ta përfaqëson me dinjitet Letërsinë Shqipe në festival dhe ashtu doli," tha shkrimitari i njohur Andre Korvin.


Pa kaluar as dy muaj, pikërisht të dielën e parë të dhjetorit (2005) Adnan Mehmeti e gjen veten prapë në qendër të vëmendjes dhe të respektit të publikut. Biblioteka publike e qytetit Lufkin, e fuqizuar nga "Miqtë e Librit," gjeneroi energjinë e vet për të hedhur dritë mbi poetin shqiptar dhe librin poetik, në anglisht, të tij.

Drejtoresha e bibliotekës Terry Bumer nuk e fshehte dot krenarinë dhe nderin që ndjente për njohjen personalisht me Mehmetin: "Është e vërtet se qytetarët flasin për të, dhe se e shtypi komentoit rreth librit të tij, por jemi ne ata që po bëjmë promovimin e 'Leave the door open,'" tha duke na drejtuar vëmendjen të tavolina ku ishte ulur autorin në fjalë.


Veshur me të bardha për t'u identifikuar si shërbyes të ditës, disa nga grupi "miqtë e librit" u tregonin blerësve se ata, pasi t'i blinin librin, mund t'i drejtohesin autorit për një autograf, kurse pjesa tjetër u kujdesën për zëvendësimin e librave të shitur dhe përmblidhjen e parave.

Po të konsiderosh numrin e lexuesve që mbanin radhën për t'u takuar me poetin "vendas" siç e quanin ata, "Miqtë e Librit" duhen njohur si shërbyesit e javëve e jo vetëm të ditës. Ata gati një muaj para datës së takimit kishin vënë në hyrje të bibliotekës një tabelë të madhe, në të cilën reklamohej kopertina e librit "Leave the door open" dhe lajmi i ditës së promovimit.

Terry Bumer ka investuar në një



Adnan Mehmeti në promovim miqësh



Adnan Mehmeti

shënim të karakterit informativ rreth këtij evenimenti. Përveç fletushkave të shpërndara në vendet e dukshme të pjesës së brendshme të bibliotekës, informacioni ka zënë vend edhe në gazetat periodike të qytetit.

Zgjedhja e ditës së diel, plot tri javë para festës së Krishtlindjeve, si dhe reklamimi i organizuar me aq efektivitet ka ecur në akord me stilin personal të jetesës së Karolina Preston-it. Ajo mbante pesë libra në dorë tek rrinte në radhë për të paguar. "Ngaqë jap anglisht, përfitova nga rasti për të blerë ca libra me autograf nga autorii, të cilat do ua dhuroj kolegëve me rastin e ditës së Krishtlindjeve," tha ajo.

Veranica Tut, Jamie Moor dhe Roger Delano i ishin gjëzuar shansit për të marrë një libër me autograf nga Adnan Mehmeti. Ndonëse të tre të lindur dhe të rritur në Lufkin, asnjëri prej tyre nuk e dinte se poeti shqiptar jetonte prej vitesh në qytetin e tyre. "Dje u detyruam të vinim në bibliotekë për të bërë ca kërkime letare për të na ndihmuar me esenë e fundit të këtij semestri, kur emri që pamë në kopertinë e librit të afishuar në atë tabelën aty [bën me dore nga tabela] na u duk i dëgjuar," po i shpjegonte një të moshuari Jamie.

Të tre ishin studentë të degës së Arteve të Bukura dhe Komunikimeve pranë Lamar University. Emri i poetit u kishte ngelur në mendje prej më se një viti, që kur Departamenti i Anglishtes dhe i Gjuhëve Moderne të këtij Universiteti e kishte nderuar Adnan Mehmetin me Çmimin e Parë për katër poezi të botuara në revistën e tyre letare Pulse.

Shpjegimi i koincidencës së tyre e vuri në reagim të menjëherëshëm Mehmetin: "Sikur kësaj bote t'i mungon poetët që kuptim do të kishte jetë. Edhe vetë dashuria do të ishte e varfër, për të tij menjëherë pas shitjes së librave që kishte sjell me vete."

e heshtur, e ndrojtur..."

Ai e di mirë se ç'është poezi për poetin e poet për poezinë. Deri më tanë, përvëc një libri me aforizma ai është edhe autor i tre vëllimeve poetike.

Studentët për të mbështetur mendimin e Mehmetit cituan një nga shprehjet e njohura të Shellit. "Poezia është një përmendore, ku janë afishuar çastet më të mira e më të lumtura të mendjeve më të mira e më të lumtura."

"Leave the door open" po i shërben autorit si çelës komunikimi jo vetëm me lexuesit e poezi të por edhe me shkrimitarët e poetët më të njohur Amerikanë. Ai tashmë shkëmben telefonata dhe mesazhe elektronike me Michael Lieberman, Mark Jodon, Sally Alter, Ann Shurgin, Allison Smythe, Lyman Grant, Sandra Acosta, Tea Lederer, Larry Fomenot etj.

Shkrimitari Andre Korvin, i cili mbajti edhe një referat të shkurtër rreth librit në fjalë, e sheh këtë komunikim si një hap pozitiv kundrejt integrimit të Mehmetit në botën letrete Amerikane.

Kurse poetja Gabriela Shulz mendon se njohjet e reja të Mehmetit, si dhe poezia e tij në Anglisht, duhet të rezultonë në një edukim më të lartë të publikut amerikan ndaj domosdoshmërisë së pavarësisë së Kosovës. Ajo tha se "Diçka mesjetare ka ekzistuar dhe ekziston aty [në Kosovë]... Kosova s'duhet në asnjë mënyrë të ketë kthim prapa."

Përdorimi prej saj i fjalës "mesjetare" konçidon edhe me simboliken që mbart në vetvete titulli i librit "Leave the door open." Sipas Mehmetit, ai është i huazuar nga legjenda e besës së kalorësve mesjetar. "Besa ndaj vendit tim, ndaj njerëzve të mi, nuk harrohet, nuk braktiset," tha ai gjatë koktejtit të shtruar për të tij menjëherë pas shitjes së librave që kishte sjell me vete.